



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 30

Prishtinë, më 19.12.2018, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Fatmir Xhelili, Xhelal Sveçla, Fadil Beka, Aida Dërguti dhe Bahrim Shabani, anëtarë.

Munguan: Ramiz Kelmendi, Zoran Mojsilović, Daut Haradinaj dhe Ismet Beqiri.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme: Ekrem Mustafa, ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Rashit Qalaj, drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Haxhi Shala , kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 02.10.2018, 03.10.2018 dhe 23.10.2018;
3. Raportimi i Ministrit të Punëve të Brendshme, z. Ekrem Mustafa dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, z. Rashit Qalaj;
4. Të ndryshme.

Kryetari i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen

1. Miratimi i rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 02.10.2018, 03.10.2018 dhe 23.10.2018

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Raportimi i Ministrit të Punëve të Brendshme, z. Ekrem Mustafa dhe drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, z. Rashit Qalaj

Kryetari, fillimisht i uroi për pozitën e re ministrin Mustafa dhe drejtorin Qalaj. Tutje kërkoi që nga ana e ministrit të paraqitet një rezyme lidhur me punën e deritanishme dhe objektivat për vitin 2019. Gjithashtu edhe nga ana e drejtorit të bëhet një rezyme lidhur me fushëveprimin e tij.

Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, theksoi se që nga momenti i pranimit të kësaj pozite është angazhuar seriozisht për t' ju përmbajtur objektive të përcaktuara. Prioritete strategjike sa i përket qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, në kuadër të fuqizimit të kapitullit shumë të rëndësishëm, atë të sundimit të rendit dhe ligjit, si dhe zbatimin e reformave kyçe në kuadër të agjendës evropiane. Tutje theksoi se ndër objektivat e tij, si Ministër do të jenë, luftimi i korrupsionit, luftimi i krimit të organizuar dhe narkotikëve, trafikimit me qenie njerëzore, luftimin e nepotizmit. Po ashtu vëmendje do të ketë edhe lufta kundër terrorizmit, duke rritur edhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar. Po ashtu rol të rëndësishëm ka edhe siguria në komunikacion, pasi ka pasur shumë humbje të njerëzve. Ky objektivi synon rritjen e kualitetit dhe kuantitetit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe me komunat.

Kujdes i veçantë do t'i kushtohet edhe fenomenit të trafikimit me qenie njerëzore, përmes fushatave dhe ndjekjes penale, si dhe fuqizimin e zbatimit të ligjit, bashkëpunimin ndërkombëtar, si dhe bashkëpunimin me institucionet vendore për mbrojtje më të mirë dhe luftimit të trafikimit me qenie njerëzore. Objektivi tjetër i tij është edhe lidhja e marrëveshjeve me shtetet fqinjë, siç është lidhja e marrëveshjeve ndërpolicore. Përveç rolit operacional me të cilin ngarkohet policia, angazhimi i autoriteteve do të jetë edhe në forcimin e bashkëpunimit me qytetarët, rritja e bashkëpunimit me organet relevante zbatuese të ligjit për shkëmbimin e informatave dhe të punohet në teknologjinë informative. Po ashtu do të fokusohen edhe në ngritjen e kapaciteteve në Inspektoratin Policor të Kosovës.

Te Agjencia për forenzikë, synohet që të bëhet rritja e kapaciteteve në kryerjen e ekspertizave, duke shtuar laboratorët e nevojshëm, si dhe ndryshimet ligjore. Avancimin e politikave për menaxhimin e integruar të kufijve dhe infrastrukturës kufitare, si dhe ngritjen e kapaciteteve në kontrollin dhe mbikëqyrjen kufitare, sipas standardeve të Shengenit, avancimin politikave në fushën e migrimit, parandalimin migrimit të parregullt dhe menaxhimin e procesit me rastin e liberalizimit të vizave për Kosovën.

Me zgjerimin e mandatit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në rrafshin ushtarak, janë krijuar rrethana të reja dhe duhet të barten disa funksione nga FSK tek agjencia për menaxhimin e

emergjencave, ngritja e kapaciteteve në këtë agjenci për menaxhimin efikas të situatave emergjente. Mbështetje për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike për afrimin e trajnimeve më të avancuara në përputhje me standardet e avancuara të akreditimit. Përmirësimi i sigurisë së dokumenteve në Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe avancimin në fushën e teknologjisë informative.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, theksoi se Policia e Kosovës i ka të përcaktuara objektivat e saj sipas planit zhvillimor strategjik 2016-2020 dhe se të gjitha aktivitetet e policisë janë në kuadër të objektivave të përcaktuara në planin strategjik. Tutje theksoi e nga momenti i marrjes së pozitës së drejtorit, ka kërkuar një auditim të brendshëm në fushën e financave, prokurimit dhe logjistikës. Hapi i dytë ka qenë ndërmarrja e veprimeve për implementimin e udhëzimeve, në respektimin e orarit të punës dhe nga veprimi i ndërmarr nuk ka më dukuri të paraqitjes së policëve në kafiteri dhe në objekte fetare gjatë orarit të punës, përveç gjatë kohës së pushimit që u takon. Po ashtu është instaluar edhe një sistem për procesin e promovimit, ku nga stacionet e caktuar vijën propozimet. Po ashtu theksoi se është në proces pranimit i kadetëve të rinj të policisë, proces i cili është zhvilluar me integritet të lartë, duke shtuar që në mungesë të pajisjeve teknike nuk arritën ta avancojnë sistemin me skaner që në momentin që plotësohet testi, të marrë edhe përgjigjeje, por theksoi se në rekrutimet e ardhshme ky sistem do të avancohet dhe rezultati do të merret në momentin që plotësohet testi.

Gjithashtu theksoi se janë bërë analiza të ndjeshme, siç është njësia anti-drogë, njësinë e inspektimeve, e krimeve ekonomike dhe sipas të gjeturave do të bëhen edhe ndryshimet e kuadrove, në mënyrë që të ketë shërbim më të mirë për qytetarët. Po ashtu janë duke u bërë përpjeke për zbatimin e rekomandimeve nga auditori i jashtëm, është filluar në rritjen e kapaciteteve të reagimit të shpejtë në të gjithë vendin, ku janë shtuar 105 zyrtarë në njësinë e reagimit të shpejtë, po ashtu është filluar në ngritjen e kapaciteteve të njësive speciale intervenuese, pasi numri aktual i pa mjaftueshëm. Po ashtu është filluar në rishikimin e strukturës organizative, proces që do të përfundojë në janar të vitit të ardhshëm dhe në këtë proces është edhe projektit i mbështetur nga BE- ja që ka të bëjë me reformimin e Policisë së Kosovës. Po ashtu synimi është edhe krijimi i njësisë për integritet, e cila njësi do të parashikohet me strukturën e ardhshme, ndërsa në fund të muajit janar do të shpallen pozitat për të gjithë komandantët e stacioneve, drejtorëve rajonalë dhe të divizioneve që janë në këto pozita më shumë se gjashtë vjet. Në të ardhmen janë planifikuar disa objektiva në fushën e hetimeve, krimeve kibernetike, pasi aktualisht vetëm një qendër është një ekip i vogël, pro që do të shtrihet edhe në rajone. Po ashtu theksoi se fokusi në vitin 2019 do të jetë luftimi i korrupsionit dhe krimin të organizuar, po ashtu do të punohet më shumë edhe në fushën e trafikut, pasi jo vetëm shqiptimi i tiketave është zgjidhja, po ashtu edhe ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e huliganizmit në sport, duke shtuar që ngritja e kapaciteteve do të ndikojë edhe në uljen e numrit të grabitjeve dhe vjedhjeve të rënda në vend.

Kryetari, fjalën ua dha anëtarëve të komisionit.

Rexhep Selimi, duke i uruar për pozitat e reja ministrin dhe drejtorinë e Policisë, kërkoi nga ta që të kenë angazhim maksimal për ushtrimin e kompetencave të tyre, të mbështet policia e Kosovës dhe të kërkohet që të zgjidhen çështjet që akoma janë të pazgjidhura, siç është rasti i vjedhjes në Dhomat e Dëshmive. Po ashtu u kërkoi që të procedohen edhe disa ligje që janë të nevojshme, siç është projektligji për pensionimin e pjesëtarëve të policisë, që pavarësisht

pengesave buxhetore duhet të bëhet zgjidhje. Po ashtu theksoi se projektligj tjetër është edhe ai që mbulon fushën e zjarrfikëses dhe shpëtimit, pasi tashmë dihet gjendja e zjarrfikësve dhe përzierja e kompetencave nga niveli qendror dhe lokal. Ndërsa sa i përket mbështetjes së komisionit, theksoi se kjo mbështetje do të jetë përgjatë shqyrtimit të buxhetit. Gjithashtu e theksoi se edhe në Inspektoratin Policor kanë qenë disa zhvillime jo pozitive, duke e vlerësuar emërimin e kryshefit si të ngutshëm, përderisa komisioni ka qenë duke e përgatitur raportin për mbikëqyrjen e Ligjit të IPK-së. Po ashtu kërkoi nga drejtori i Policisë, që deri në fund të vitit të silltet një raport statistikor, sa i përket punës së policisë së Kosovës. Po ashtu kërkoi që nga drejtori i Policisë, të analizohet dhe të bëhet zgjidhje që ruajtja e objekteve të mos bëhet nga zyrtarët policorë, por të bëhet nga kompanitë private të sigurisë, në mënyrë që zyrtarët policorë të angazhohen në punë të tjera, gjithashtu e vlerësoi si jo të drejtë suspendimin e një zyrtari policor, pasi ai kishte dhënë informacione për rastin e djalit të drejtorit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.

Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, në përgjigjeje të pyetjeve të shtruara nga z. Selimi, theksoi se sa i përket projektligjit për pensionimin e pjesëtarëve të policisë e ka diskutuar edhe me Ministrin e Financave, ku është diskutuar për moshën e pensionimit dhe është analizuar që nëse moshë 55 vjeçare krijon implikime më të mëdha buxhetore, të rritet moshë e pensionimit. Ndërsa sa i përket projektligjit për zjarrfikësit, theksoi se është votuar nga ana e Qeverisë, dhe është përfshirë që zjarrfikësit të jenë nën ombrellën e nivelit qendror. Po ashtu theksoi se edhe Ministria e Financave ka marrë vendimin dhe u janë kompensuar orët shtesë, po ashtu është duke u punuar në zgjerimin e kapaciteteve, pasi me ndërrimin e mandatit të FSK-së, rriten përgjegjësit për Agjencinë për Menaxhimin e emergjencave. Ndërsa sa i përket projektligjit për buxhetin, theksoi se ka qenë i dorëzuar në momentin që ka ardhur në pozitën e ministrit, kërkesat nga ana e ministrisë kanë qenë më të mëdha. Ndërsa sa i përket funksionimit të IPK-së, edhe nga vizita që ka pasur, u ka kërkuar që të jenë sa më profesional dhe se nuk është i kënaqur me disa aspekte të funksionimit të saj. Po ashtu theksoi se është i kënaqur me punën e policisë, ku është arritur të vendoset në agjendën për votimin në INTERPOL, pavarësisht që nuk ka arritur të jetë pjesë e këtij mekanizmi.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, sa i përket nevojës së miratimit të projektligjit për pensionimin pjesëtarëve të policisë, e konsideroi më se të nevojshme, edhe pse ka implikime buxhetore kjo gjë duhet të bëhet, pasi edhe organizata ka nevojë të ripërtërihet. Ndërsa sa i përket raportit të punës i dhënë me statistika, theksoi se shpejt do t'i dërgohet komisionit.

Ndërsa sa i përket rastit të suspendimit të këtij zyrtari policor, theksoi se suspendimi është bërë për shkak të qasjes së pa autorizuar të këtij zyrtari në bazën e të dhënave që është e klasifikuar, polici i suspenduar ka pasur disa hyrje në sistem, mirëpo një rast ka qenë i pa arsyetuar. Nga ana e tij është kërkuar nga IPK-ja që të shtojë rastin dhe është konstatuar që personi ka hyrë në sistem i pa autorizuar. Ndërsa sa i përket INTERPOL-it, theksoi se është bërë një punë mjaft e mirë, pavarësisht se nuk është anëtarësuar, do të bëhen përpjekjet në vazhdimësi për anëtarësim. Ndërsa sa i përket afrimit të sigurisë në objekte nga ana e policisë, theksoi se edhe nga ana e tyre ka interesim për këtë çështje, është bërë kërkesë në Qeveri por nuk është implemetuar kjo kërkesë. Po ashtu është përgatitur një shkresë e përcjell te ministri, që të lirohen policët në ato pjesë ku nuk është shumë e nevojshme.

Aida Dërguti, shtroi pyetje për drejtorin e Policisë z. Qalaj. Në mesin e prioritete të përmendura nga ai, ishte edhe konflikti i interesit. A është vërejtur që ka mungesë të infrastrukturës ligjore apo shkelje të ligjit, në luftimin këtij fenomeni?

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, në përgjigjeje të pyetjes theksoi se për këtë çështje në kuadër të policisë nuk ka pasur as zyrtar, e as njësi që merren me luftimin e konfliktit të interesit. Tutje theksoi se nga janari në kuadër të njësisë për hetime të brendshme, do të jetë edhe zyrtari përgjegjës për luftimin e konfliktit të interesit.

Fatmir Xhelili shtroi pyetje për drejtorin e Përgjithshëm të Policisë. Duke qenë se kohët e fundit ka pasur raste të shpeshta të grabitjeve në shtëpia private dhe në banka dhe ky fenomen reflekton në shumë drejtime, duke rritur frikën në raport me qytetarët, por edhe dëmtimi i imazhit të shtetit. A janë ndërmerren hapat e nevojshëm dhe ndërmarrja e ndonjë operacioni afatgjatë që do të reflekton në luftimin e këtij fenomeni dhe arrestimin e këtyre personave? Sa është e përkushtuar policia për zhvillimin e policimit inteligjentë? A është i mjaftueshëm numri i pjesëtarëve të njësisë operative? Sa është koha e reagimit jashtë qendrave, mos është koha shumë e gjatë në reagim?

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, në përgjigjeje të pyetjeve të z. Xhelili, theksoi se janë në dijeni me rastin e grabitjeve të shumta këtë vit, duke shtuar që grabitje kanë efekt më pas përveç dëmit material, por është duke u bërë më shumë në luftimin e këtij fenomeni. Është hartuar plani operativ dhe shtoi se në rajonin e Prishtinës mungojnë dyqind policë, por me pranimin e kadetëve të rinj ky problem do të zgjidhet. Po ashtu theksoi se kjo ka qenë arsye e rritjes së njësisë speciale dhe të reagimit të shpejtë, për shkak se njësitë e reagimit të shpejtë janë të shpërndarë në gjithë Kosovën. Ndërsa sa i përket njësisë së reagimit të shpejtë, është shpërndarë në qytete më të mëdha, pasi ka raste të krimeve në këto qytete, pra numri do të shtohet sipas nevojës.

Fatmir Xhelili shtroi pyetje për ministrin. Është një numër prej dhjetë pjesëtarëve të cilët kanë qenë me kontratë pune të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të cilët kanë përfunduar akademinë policore në Turqi, ndërkaq për shkak të mos rregullit të kontratës pas kthimit, këta persona kanë mbetur pa punë. Ky problem është duke zgajtur që disa vite, nga ana e tyre është kërkuar ndihmë nga komisioni dhe personalisht nga ana e tij. Për këtë arsye, kërkoi që nga ana e ministrit të trajtoj këtë çështje, pasi ka obligim moral në zgjidhjen e kësaj çështje.

Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, theksoi se nuk ka pasur njohuri me këtë rast, pro që me ndihmën edhe të komisionit do të arrihet të bëhet zgjidhja, qoftë në kuadër të policisë apo të ministrisë.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, për çështjen e ngritur nga z. Xhelili, theksoi se këta persona janë inkurajuar që të aplikojnë në policinë e Kosovës, pasi mos nënshtrimi i trajnimit bazike në policinë e Kosovës ka bërë që ata mos të sistemohen, pasi ata kanë shkuar në trajnim si qytetarë të Kosovës, por jo si pjesëtarë të Policisë së Kosovës.

Xhelal Sveçla, nga diskutimi i deritanishëm, theksoi se nuk u përmend siguria në veri të vendit, ndërkaq kjo çështje do duhej të ishte në fokus të diskutimit. Tutje shtroi pyetjet për ministrin dhe

drejtorin. A ka ministri ndonjë plan për të shtrirë sovranitetin edhe më shumë në pjesën veriore? A ka ndonjë plan operativ për parandalimin e ndonjë proteste, apo eskalimin e situatës? A punohet më shume te rastet e “ftohta”? A është duke u punuar në zgjidhjen e katere rasteve? Gjithashtu kërkoi të jepen informacione me rastin e arrestimit të z. Slobodan Petroviq, dhe ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e tij dhe familjes së tij? Duke e ditur që Milan Radojeviq është në kërkim, a ndodhet në Kosovë apo jashtë Kosovës? Ndërsa sa i përket punës së Komisionit Hetimor, në të cilën është kryesues vet z. Sveçla, është kërkuar nga ana e policisë së Kosovës për disa dëshmi dhe ende nuk janë afuar këto dëshmi. Çfarë ka ndodhur me kërkesën e komisionit për ofrimin e dëshmive? A do të merren masa ndaj zyrtarëve që nuk kanë ofruar këto dëshmi? A ndërmerren masa ndaj atyre zyrtarëve policorë, që shihen në shoqërinë e personave të dyshuar? Sa zyrtar policor janë të dënuar me vendime të gjykatave dhe vazhdojnë të shërbejnë në policinë e Kosovës? A është fokusuar policia në ngritjen e bashkëpunimit me Forcën e Sigurisë së Kosovës, duke qenë se mandati i tyre do të ndryshojë? Përderisa është fundi i vitit, si do të menaxhohet përdorimi i fishekzjarrëve? Tutje theksoi se ministri i Infrastrukturës ka dëshmuar se ka dërguar një shkresë te ministri i Punëve të Brendshme, me kërkesën për t’u informuar për shkeljet që avio-kompania turke ka bërë me rastin e depërtimit të gjashtë shtetasve turq, dhe ka njoftuar që nuk ka marrë asnjë përgjigjeje. A mendoni se kjo është në rregull dhe e pranueshme dhe kur do të përgjigjet ministria? Te bashkëpunimi mes AKI-së dhe policisë, policia është ankuar për mungesën e bashkëpunimit mes dy institucioneve, a është plani që kjo marrëveshje të realizohet dhe të specifikohet roli i secilit komision?

Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, në përgjigjeje të pyetjeve të bëra, theksoi se sa i përket situatës në veri dhe shtrirjes së sovranitetit, theksoi se në fillim janë realizuar disa takime me drejtorin e Policisë, gjithashtu ka pasur takime me drejtorët e policisë në komunat e veriut, po ashtu është dyshuar që sovraniteti i Kosovës është i pacenueshëm, ku është arritur që të burgosën persona që dyshohen për vrasjen e z. Ivanoviq. Janë ndërmarrë masa për ngritjen e nivelit të sigurisë, janë bërë përgatitje logjistike dhe mënyrës së bashkëpunimit me policinë. Policia ka përgatitur planin operativ. Qeveria ka miratuar ligjin sa i përket zhurmave dhe prishjes së qetësisë publike, dhe është rënë dakord me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, që fishekzjarrët mos të shiten në rrugë dhe të caktohet një kohë kur mund të përdoren dhe mos të ketë mundësi të blejnë fishekzjarrë personat nën moshën 18 vjeçare. Sa i përket memorandumit me AKI, theksoi se janë të gatshëm të ngritët bashkëpunimi, pasi edhe për këtë çështje është biseduar me drejtorin e AKI-së. Ndërsa sa i përket përgjigjeje për Ministrinë e Infrastrukturës, theksoi se është duke u analizuar mënyra se e kujt ka qenë përgjegjësia për t’i dhënë lejen e aterimit aeroplanit me rastin e depërtimit të qytetarëve turq.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, sa i përket situatën në veri, theksoi se në përgjithësi është stabile, por në disa raste është me tensione. Situata e sigurisë është më stabile se në vitet e mëhershme, ka pasur protesta dhe reagime me rastin vendosjes së taksës nga Qeveria e Kosovës, pjesëmarrja nuk është e madhe dhe janë situata të menaxhueshme. Policia e Kosovës është e përgatitur edhe për skenar të tjerë, është bërë përforsimi i pikave dhe vijave kufitare në veri, ka patrullime të shtuara, është duke u bërë siguri statik për pjesëtarët e FSK-së, pasi vetëm pjesëtarët e FSK-së nga Zubin Potoku kanë kërkuar mbrojtjen policore, por jo ata të Mitrovicës dhe Leposaviqit. Janë 22 shtëpi që ruhen dhe kërkohet angazhim nga policia. Policia është duke u marrë me rastet që janë bërë publike, siç ka qenë rasti i vjedhjes së dhomës së dëshmive dhe është duke u hetuar, ndërsa sa i përket deputetit Petroviq, jemi duke ofruar

mbështetje, është pajisur me leje të armës, i është ofruar mbrojtje e afërt dhe kërkesat e tij kanë qenë të arsyeshme.

Ndërsa sa i përket personit në kërkim z. Radojeviq, sipas vlerësimeve të policisë është në pjesën serbe të Kopaunikut. Sa i përket kërkesës së Komisionit Hetimor për dëshmi, theksoi se nuk ka qenë në njohuri për këtë kërkesë dhe kjo kërkesë do të shqyrtohet dhe do t'u kthehet përgjigjeje. Ndërsa sa i përket imazhit të policisë, theksoi se është duke u punuar në këtë drejtim, ndërsa sa i përket numrit të zyrtarëve policorë, që janë të dënuar me vendim të gjykatës, këto të dhëna do të merren deri në fund të javës dhe do t'i përcillet komisionit. Për planin operativ për fund të vitit, theksoi se do të fillon të implementohet të premtën, ndërsa sa i përket bashkëpunimit me FSK-në do të jetë bashkëpunim i ngushtë, ndërsa sa i përket memorandumit të mirëkuptimit me AKI-në, është përgatitur dhe është duke u analizuar dhe është në interes të dy palëve.

Bahrim Shabani, uroi për pozitën e re ministrin dhe drejtorin, dhe shtroi disa pyetje. Sa i përket ligjit për pensionimin e pjesëtarëve të policisë, theksoi se është më se i nevojshëm për të rritur efikasitetin e punës, pasi siç tashmë dihet policia e Kosovës është më e vjetra në rajon. Gjithashtu është edhe një problem për të cilin janë ankuar zyrtarët policorë, sa i përket çështjes së transportit, makinave. Po ashtu është shqetësuese, që zyrtarët policorë duhet të shërbejnë edhe gjatë natës në temperatura të ulëta, ndërsa pagesa që parashihet për këtë shërbim është e ulët në krahasim me rrezikshmërinë e tij në punë. Po ashtu theksoi se sa i përket procesit të rekrutimit të kadetëve të rinj në polici, kërkoi që t'i përmbahen kriterit për përfshirje etnike të mjaftueshme, pasi kur theksohet përfshirja e minoriteteve, të mos bëhet fokusimi vetëm në komunitetin serb, por edhe në komunitetet e tjera.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, lidhur me çështjet e shtruar nga z. Shabani, theksoi se është e vërtetë që është një numër i madh i veturave, por disa janë jo funksionale. Është duke u punuar shumë në këtë drejtim në mënyrë që të bëhet kujdes në përdorimin e veturave të policisë, duke theksuar se siç përmendi edhe më herët ka anuluar disa tenderë në fillim të marrjes së detyrës, pasi është kundër asaj që pajisjet e veçanta siç janë ato të përgjimit, të blihen me tender të hapur. Po ashtu është duke u punuar bashkërisht me FSK-në për standardizimin e veturave, me qëllim që mos të ketë më shumë se katër lloje të veturave. Ndërsa sa i përket procesit të rekrutimit në polici, theksoi se janë bërë fushata që sa më shumë të aplikojnë komunitete jo shumicë, por që testi do të jetë i njëjtë për të gjithë në mënyrë që të ketë kualitet dhe jo me standarde të dyfishta. Po ashtu theksoi se në polici nuk ka pjesëtarë të komunitetit kroat, duke shtuar që në listën e pritjes do të zgjidhen në mënyrë meritore të gjithë kandidatët që mund t'i plotësojnë kriteret, qoftë nga komuniteti boshnjak, goran dhe të tjerë. Po ashtu theksoi se nga Qeveria është dhënë rekomandimi për procesin e rekrutimit sa i përket komunitetit jo shumicë, por që procesi ka qenë në zhvillim e sipër.

Kryetari shtroi disa pyetje për ministrin dhe drejtorin, të cilat janë drejtuar nga qytetarët në adresë të komisionit. Pse është në rritje numri i aksidenteve të trafikut? Pse ka ngritje të rasteve të grabitjeve ndaj qytetarëve? Çfarë është duke ndodhur me hapjen e lokaleve me lojëra të fatit në disa fshatra të Kosovës, a kanë leje, kush i kontrollon? A kontrollohen edhe lokalet që ushtrojnë aktivitete të dyshuara? Po ashtu thekso se ka një kërkesë nga qytetarët e lagjes "Qëndresa" ku pjesa më e madhe e shtëpive të kësaj lagje, kanë qenë viktimat të vjedhjes, thyerjeve të shtëpive. Çfarë është duke u bërë në luftimin e këtij fenomeni, a ka ndërmarrë policia ndonjë masë konkrete? Problematikë tjetër është edhe funksionimi i një lokali në këtë

lagje, i quajtur “Pentagon” i cili krijon shqetësime pasi funksionon jashtë orarit të punës. Për këtë arsye kërkoi që nga policia të ndërmerren veprime konkrete për këto çështje, duke kërkuar që në raportimin e radhës të jepen përgjigjeje për këto pyetje.

4. Të ndryshme

Kryetari, me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi takimin e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Haxhi Shala